



Si duhet vepruar pas dhunës raciste?

Beratungsstellen für Betroffene rechtsextremer und rassistischer Gewalt in NRW

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, të dashura Familje,

pas udhëtimeve të gjata Ju keni mbërritur në Gjermani. Sigurisht që rruga për Ju nuk ka qenë e lehtë. Dhe për fat të keq edhe këtu nuk është gjithçka e lehtë. Shumë njerëz në Gjermani Ju mirëpresin. Por ka edhe njerëz të tillë, të cilët kanë qëndrime raciste. Ka sulme dhe diskriminime – gjithashtu shpesh edhe kundër azilkërkueseve.

Në rast se Ju, të afërmit tuaj apo shoqet dhe shokët do të sulmohen nga neonazistët apo për arsye racizmi, tek ne do të gjeni ndihmë dhe mbështetje. Ne Ju këshillojmë gratis, në vend dhe me dëshirë edhe në formë anonime. Ne Ju shoqërojmë në polici, tek autoritetet zyrtare, tek mjeket dhe mjekët dhe në procedura gjyqësore. Ne organizojmë përkthyes dhe përkthyes, japim udhëzime ligjore dhe mbështesim në kërkim të avokateve dhe avokatëve apo në shoqërim terapie.

Ne këtu kemi përmbledhur disa informacione të shkurtra por të rëndësishme. Luteni t'i transmetoni këto më tej edhe njerëzve të tjerë!

Për një bisedë ne mund të na kontaktoni përmes telefonit apo e-mailit – njoftohuni me kënaqësi. Pastaj ne do të shohim, se cilat hapa do të ndihmojnë, me qëllim për të përballuar bashkërisht një situatë të vështirë. Ne jemi në anën tuaj dhe ju mbështesim – asnjë nuk ka pse të jetë i vetëm.

Bordi i konsultimit për viktime në NRW

Çfarë duhet të dini Ju pas një sulmi racist

Si viktime të një akti të dhunës Ju keni të drejta si edhe qytetarët dhe qytetarët gjermanë. Në rast se do të vendosni për një kallëzim penal në polici, nuk duhet të frikësoheni për ndonjë ndikim negativ në procedurën tuaj të azilit. Në rast se Ju kërcënoheni në mënyrë akute për dëbim, mund të bëhet kërkesë për një të ashtuquajtur leje-qëndrim „Duldung“, mbasi do t'ju duhet të dëshmoni si dëshmitare/dëshmitar kundër sulmueseve në një proces gjyqi.

Ju nuk jeni i/e detyruar të dëshmoni në polici – dëshmia si dëshmitar/e lidhet me vendimin tuaj të lirë! Edhe në rastin kur policia p.sh. pas sulmit do të vijë në spital dhe do t'u lutet, që të shkoni me ta menjëherë, këtë gjë Ju mund t'a refuzoni. Ndryshon puna në prokurori apo gjykatë: Ju duhet të paraqiteni në prokurori apo gjykatë, në rast se duhet të jepni një dëshmi.





Infopaket Flucht und Asyl

Ju keni të drejtë të shoqëroheni prej dikujt në marrjen në pyetje. Një „person i tillë i besimit tuaj“ mund të vijë me vete në polici, në prokurori apo në gjykatë. Policia duhet të kujdeset për atë, që të jetë e pranishme një përkthyes apo një përkthyes, që do të përkthejë për Ju, me qëllim për të mos pasur vështirësi, që të kuptoni. Kjo është një e drejtë e rëndësishme! Ju keni mundësi dhe duhet të këmbëngulni për këtë. Në këtë mënyrë, gjithçka që Ju keni perceptuar, duhet të shkruhet dhe të regjistrohet sa më saktë që të jetë e mundur. Në rast se dëshironi, atëherë natyrisht që ne Ju shoqërojmë edhe në marrjen në pyetje.

Pas një sulmi fizik Ju duhet të shkoni tek një mjek apo mjeke. Aty shënohen me hollësi të gjitha lëndimet. Ju mundeni dhe duhet të njoftoheni me hollësi lidhur me lëndimet. Një „Vërtetim“ i tillë është shumë i rëndësishëm! Spitalet janë të detyruar, që t’ju trajtojnë në rast urgjence! Kjo ndodh edhe atëherë, kur Ju nuk e keni marrë nga zyra e socialit dëshminë e sigurimit shëndetësor. Për të gjithë ata, që janë lënduar nga një sulm racist, vlen: Ju keni mundësi, që të merrni një dëmshpërblim financiar. Për një dëmshpërblim nuk është e nevojshme të jenë të njohur autorët apo autoret e veprës.

Në rast se vendstrehimi apo banesa juaj janë bërë si pikë-shënjestër i një sulmi, atëherë mundësisht mos prekni dhe mos largoni deri në ardhjen e policisë asgjë çfarë ka lidhje me sulmin, (p.sh. gurë, shishe, afishe). Mirë do të jetë, në rast se Ju do të bëni fotografi me telefona celularë.

Në rast se jeni lënduar, atëherë në një proces penal keni të drejtë në kushte të veçanta, që kundër autorëve apo autoreve të veprës, të merrni një avokate apo një avokat. Kjo ka shumë përparësi. Ka shumë mundësi të ndryshme, që të merrni ndihmë për shpenzimet. Lidhur me këtë ne me kënaqësi do t’u kthejmë përgjigje pyetjeve tuaja, dhe së bashku të gjejmë zgjidhje.

Quelle: <http://www.agg-ratgeber.de/checkliste.php> + <http://www.agg-ratgeber.de/unterstuetzung-durch-beratungsstellen.php>

Në Nordrhein-Westfalen (NRW) ekzistojnë dy qendra këshilluese për persona të prekur nga dhuna ekstremiste e krahut të djathtë dhe ajo raciste: Back Up in Dortmund është përgjegjëse për territorin Westfalen-Lippe (Zyra qendrore Arnsberg, Detmold dhe Münster). Qendra këshilluese Rheinland (OBR) në Düsseldorf është qendër referimi për persona të prekur në territorin e zyrave qendrore të bicirkuat Düsseldorf dhe Köln.

Qendrat këshilluese për persona të prekur nga dhuna raciste e krahut të djathtë dhe ajo raciste në NRW

Back Up - Beratung für Opfer rechtsextremer und rassistischer Gewalt

Königswall 36
44137 Dortmund
Tel: 0231 53200941
Fax: 0231 53200944
backup-nrw.org

Opferberatung Rheinland(OBR) – Beratung und Unterstützung für Betroffene rechtsextremer und rassistischer Gewalt c/o IDA-NRW

Volmerswertherstraße 20
40221 Düsseldorf
Tel: 0211 159255 66
Fax: 0211 159255 69
www.opferberatung-rheinland.de